



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:058099

Datë: 24.07.2024

Numri i dokumentit: 05977388

KPPP.nr.1343/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Herc International” D.O.O, me NRB: 811030072, me seli në Shtërpce, të cilin e përfaqëson Fatos Zeqiri, avokat nga Prishtina, me seli në Prishtinë kundër debitorit E.D. B.I., me NUI: 811307744, me seli në Rr. “Dëshmorëve”, p.n. në Komunën e Dragashit, të cilin e përfaqëson, Ardit Rifaj, avokat nga Dragashi, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.812/23 të datës 06.07.2023, të Përmbartuesit Privat Atip Mustafa me seli në Vushtrri, jashtë seancës, me datë 24.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit E.D. B.I., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.812/23 të datës 06.07.2023, të Përmbartuesit Privat Atip Mustafa.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.812/23 i datës 06.07.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa.
- III. URDHËROHET debitori E.D. B.I., që në rast të parashtrimit ankesës, të deponoj në llogari të veçantë të “Këshillit Gjyqësor të Kosovës”, nëpërmjet arkës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, garancionin në shumën prej 5,262.57 €, (pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy euro e pesëdhjetë e shtatë cent), në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimin të këtij aktvendimi.
- IV. Nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Herc International” D.O.O., ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.812/23 të datës 06.07.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 248/2022 të datës 30.09.2022, dhe Faturës Nr. 367/2022 të datës 21.11.2022; me të cilën është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga faturat e lartcekura të i’u paguaj kreditorit shumën prej 5,262.57 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 03.02.2021, prej ditës kur debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit e deri në përmbushjen definitive të tij, si dhe të obligohet debitori që në emër të shpenzimeve të procedurës përmbarimore t’ia kompensoj kreditori shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbarim në shumën prej 104.00 €, si dhe shpenzimet tjera përmbarimore që do të krijohen me rastin e zhvillimit të kësaj procedure.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se faturat që janë konsideruar si dokument i besueshëm në këtë rast janë të pabazuara, sepse kreditori nuk i është përmbajtur kontratës në bazë të së cilës i ka lëshuar faturat kontestuese. Ka shtuar që në rastin konkret kreditori është lajmëruar nga ana e debitorit për ndërprerjen e sinjaleve për klientët të cilët nuk i kanë kryer pagesat tek debitori i cili është operator i shpërndarjes së internetit dhe shërbimeve të IPTV-së, ndërsa kreditori në mënyrë të heshtur ka shpërfillur një kërkesë të tillë edhe pse i njëjti ka qenë i obliguar që të veproj sipas kërkesës së debitorit dhe në përputhje me kontratën të cilën e kanë lidhur palët ndërgjyqëse. Në fund ka theksuar se debitori nuk ka asnjë detyrim të pashlyer duke i propozuar Gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të obligohet kreditori që ti paguaj shpenzimet e kësaj procedure.

Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se kreditori dhe debitori me datë 01.09.2022 ka lidhur kontratë për përdorim të shërbimit të telekomunikacionit-qasjes së drejtpërdrejt në internet, ku në bazë të kësaj kontrate debitori edhe është faturuar nga kreditori për shërbimet e kryera. Ka shtuar që kreditori e ka njoftuar debitorin për obligimet e mbetura që nga data kur i njëjti ka rënë në vonesë, ndërsa debitori nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për kryerjen e obligimeve të mbetura në shumën siç është kërkuar në propozimin për përmbarim. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar mirëpo nuk i ka specifikuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm: Faturën Nr. 248/2022 të datës 30.09.2022 dhe Faturën Nr. 367/2022 të datës 21.11.2022, të cilat fatura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal, si dhe mbajnë nënshkrimin e pranimit nga debitori.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin që në rast të parashtrimit të ankesë kundër këtij aktvendimi, të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar si në këtë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1343/23, datë 24.07.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.